

Drejtuar:

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Rr. Elbasanit, Pallati EDIL-AL-IT, PO Box 1437,
Tiranë,
Shqipëri

Dr. Kledian Kodra, FCCA, AL
Rr. "Sami Frashëri", Kompleksi
T.I.D, Hyrja, F, Kati 1
1001 Tiranë
Shqipëri
T +355 69 20 81 370
E kledi.kodra@al.gt.com

24-sht-25

Lënda: Aplikim për anëtar të Këshillit Drejtues të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar

Të nderuar anëtarë të Asamblesë së Përgjithshme të IEKA,

Me anë të kësaj letre, dëshiroj të paraqes interesin dhe kandidaturën time për anëtar të Këshillit Drejtues të IEKA duke qenë i bindur në kontributin që do të sjellë eksperiencia ime profesionale si dhe angazhimi im i vazhdueshëm në zhvillimin e profesionit të audituesit ligjor, në drejtimin e veprimtarisë së Institutit.

Me një eksperiencë 24 vjeçare në fushën e auditimit të jashtëm dhe të brendshëm, dhënies së sigurisë dhe kontrollit të cilësisë, kam shërbyer si partner drejtues në auditimin e shoqërive brenda dhe jashtë vendit të cilat operojnë në industri të ndryshme si banka, kompani sigurimi, shoqëri tregtare me kapital shtetëror, institucione financiare jo-banka, fonde pensioni dhe investimi, OJF dhe shoqëri në fushën e tregtisë dhe ndërtimit. Kjo eksperiencë më ka mundësuar njohjen e thelluar të praktikave më të mira në fushën e auditimit, Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit & Sigurisë dhe atyre të Etikës në industri të ndryshme duke nxitur vazhdimisht cilësinë, përputhshmërinë dhe transparencën në fushën e auditimit.

Përvoja ime profesionale përfshin edhe eksperiencën në fushën e konsulencës financiare, raportimit financiar, kontabilitetit, kontrollit financiar, të cilat do të më mundësojnë një kontribut edhe më gjithëpërfshirës në drejtimin e veprimtarisë së Institucionit si hartimin e moduleve të trajnimit, zhvillimin e rregulloreve dhe administrimin e pasurisë së Institutit. Gjithashtu eksperiencia ime në hartimin e kurrikulave dhe organizimin e trajnimeve në fushën e kontabilitetit dhe auditimit si dhe ajo pedagogjike në universitete private dhe publike në Shqipëri më kanë dhënë mundësinë që të jem njohës i mirë i programeve dhe formimit akademik në fushën e auditimit. Kjo ekspertizë, e mbështetur edhe në tendencat dhe kërkesat më të fundit ndërkombëtare në fushën e auditimit, do të kontribuojnë në arritjen e objektivave të IEKA-s, duke sjellë praktika dhe metoda të avancuara në zhvillimin e profesionistëve të rinj.

Jam i bindur se përmes angazhimit tim aktiv, lobimit në organizata dhe organizma qeveritare dhe eksperiencës profesionale do të kontribuoj pozitivisht në zhvillimin e IEKA-s, profesionit të audituesit, si dhe formimin e profesionistëve të rinj.

Duke iu falënderuar paraprakisht, mbetem në dispozicionin tuaj për çdo informacion shtesë.

Me respekt,

Dr. Kledian Kodra, FCCA, AL

